



100 Vjet Pavarësi

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
AUTORITETI I KOMUNIKIMEVE ELEKTRONIKE DHE POSTARE
-Këshilli Drejtues-

V E N D I M

Nr.2067, datë 14.06.2012

Për

Mbylljen e procedimit administrativ të filluar me VKD nr. 1912, datë 30.4.2012, për “Fillimin e procedimit administrativ për zgjidhjen e mosmarrëveshjes së interkoneksionit për shërbimet e thirrjes me kartë midis sipërmarrësve Media+Tel sh.p.k. dhe Albtelcom sh.a.””

Këshilli Drejtues (KD) i Autoritetit të Komunikimeve Elektronike dhe Postare (AKEP), i përbërë nga:

1. Z. Piro	Xhixho	Kryetar
2. Z. Alban	Karapici	Anëtar
3. Znj. Alketa	Mukavelati	Anëtar
4. Z. Benon	Paloka	Anëtar
5. Znj. Zamira	Nurçe	Anëtar

dhe sekretare Znj. Marsida Drushku, në mbledhjen e datës 14.06.2012, sipas procedurës së përcaktuar në ligjin nr. 9918, datë 19.05.2008 “Për Komunikimet Elektronike në Republikën e Shqipërisë”, ligjin nr. 8480, datë 27. 05.1999 “Për funksionimin e organeve kolegjiale të administratës shtetërore dhe enteve publike” dhe Rregullores së Brendshme të AKEP-it, shqyrtoi çështjen me objekt:

Mbyllja e procedimit administrativ të filluar me VKD nr. 1912, datë 30.4.2012, për Fillimin e procedimit administrativ për zgjidhjen e mosmarrëveshjes së interkoneksionit për shërbimet e thirrjes me kartë midis sipërmarrësve Media+Tel sh.p.k. dhe Albtelcom sh.a.””, të shoqëruar nga materialet:

- Raport përmbledhës (*Raporti*);
- Projekt Vendim i KD (*Projekt Akti*);
- Dokumentet shkresore të palëve (*Provat, Pretendimet*);

BAZA LIGJORE:

1. Neni 49, neni 50 pika 1, neni 60 dhe neni 120 e vijues, të Ligjit nr. 9918, datë 19.05.2008 “Për Komunikimet Elektronike në Republikën e Shqipërisë” (*Ligji nr. 9918*);
2. Neni 46 e vijues të ligjit nr. 8485, datë 12.05.1999 “Kodi i Procedurave Administrative” (K.Pr.A);
3. Rregullore “Për procedurat e zgjidhjes së mosmarrëveshjeve”, miratuar me Vendim të Këshillit Drejtues të AKEP nr. 1296, datë 11.06.2010;
4. Rregullore “Për Aksesin dhe Interkoneksionin, miratuar VKD nr. 1300, datë 14.06.2010 e ndryshuar;
5. Pika 17 e nenit 21 të “Rregullores së Brendshme të AKEP (*Rregullorja e Brendshme*), miratuar me Vendim të Këshillit Drejtues të ERT-së, nr. 170, datë 24.04.2004, e ndryshuar dhe në fuqi sipas pikës 3 të nenit 138 të Ligjit nr. 9918.

K Ë SHILLI DREJTUES:

Nga shqyrtimi i materialit shkresor, të përbërë nga:

- Vendimi nr. 1912, datë 30.4.2012, për “*Fillimin e procedimit administrativ për zgjidhjen e mosmarrëveshjes së interkoneksionit për shërbimet e thirrjes me kartë midis sipërmarrësve Media+Tel sh.p.k. dhe Albtelecom sh.a.*”;
- Shkresën me nr. 2539Prot., datë 21.5.2012, (nr. 572/9Prot., i AKEP, datë 21.5.2012) “*Mbi depozitimin e pretendimeve të Albtelecom sh.a. mbi mosmarrëveshjen me Media + Tel sh.p.k.*”, si edhe,
- diskutimeve në mbledhje mbi çështjen si dhe bazës ligjore të sipërcituar,

V Ë R E N:

- I. AKEP me anë të Vendimit nr. 1912, datë 30.4.2012, për “*Fillimin e procedimit administrativ për zgjidhjen e mosmarrëveshjes së interkoneksionit për shërbimet e thirrjes me kartë midis sipërmarrësve Media+Tel sh.p.k. dhe Albtelecom sh.a.*”, në pikat 1, 3 dhe 4 të tij ka vendosur:

- “Të fillojë procedim administrativ, për zgjidhjen e mosmarrëveshjes së interkoneksionit midis sipërmarrësve sipërmarrësve Media+Tel sh.p.k. dhe Albtelecom sh.a.”;
 - Të njoftohen palët e interesuara sipërmarrësve Media+Tel sh.p.k. dhe Albtelecom sh.a., për fillimin e procedimit administrativ;
 - Palët të depozitojnë pretendimet e tyre me shkrim brenda 15 ditëve nga marrja e vendimit;
- II. Albtelecom sh.a. me shkresën nr. 2539Prot., datë 21.5.2012, ka sjellë pretendimet “Për procedimit administrativ për zgjidhjen e mosmarrëveshjes me Media+Tel sh.p.k.” Bëjmë me dije se këto pretendime janë sjellë jashtë afatit të përcaktuar sipas pikës 4, të vendimit nr. 1912.
- Albtelecom sh.a., në këto pretendime sqaron se:
 Me shkresën nr. 4948Prot., datë 1.11.2011, ka njoftuar Media+Tel sh.p.k. për plotësim dokumentacioni për nënshkrimin e MI së re për akses/interkoneksion për OSHKP mes Media+Tel sh.p.k. dhe Albtelecom.
- Media + Tel sh.p.k. nuk ka pranuar nënshkrimin e kesaj MI duke pretenduar se është e pabazuar në RIO dhe kuadrin rregullator në fuqi.
- Albtelecom gjatë kësaj periudhe ofrimin e SHKP ndaj Media+Tel, duke mos krijuar probleme në ecurinë e biznesit por duke rrezikuar Albtelecom sepse ky shërbim ofrohej pa garanci financiare nga Media+Tel.
- Media +Tel edhe në takimin e datës 27.4.2012, shprehu qëndrimin e tij në lidhje me kërkesën për uljen e tarifës së shërbimit të origjinimit, tarifë e cila hyri në fuqi me VKD nr.1348, 27.8.2010, dhe është aplikuar nga Albtelecom në vlerën 3.5 lekë/min dhe 0.83 lekë/thirrje, që nga 1.9.2010, për të gjithë operatorët e SHKP.
- Albtelecom argumenton se:
 Tarifa për shërbimin e origjinimit të thirrjeve është tarifë nën rregullim dhe e miratuar me VKD nr. 1348, datë 26.7.2010, “Përcaktimin e sipërmarrësit Albtelecom sh.a. me fuqi të ndjeshme në treg dhe vendosjen e masave rregulluese në tregjet me pakicë të telefonisë fikse dhe tregjet me shumicë të interkoneksionit të telefonisë fikse”, ndryshuar me VKD nr. 1439, datë 3.11.2010.
- Albtelecom ka zbatuar rregullisht detyrimin për dhënie akses si dhe detyrimin për mosdiskriminim lidhur me tarifat jokomerciale, duke aplikuar të njëjtat tarifa për të gjithë OSHKP.
- Lidhur me ofertën “Fol Fix 1500”, të Albtelecom sqarojmë se tarifat e telefonisë fikse të ofruara nga Albtelecom janë objekt kontrolli dhe rregullimi nga AKEP në zbatim të VKD nr. 1348, dhe Albtelecom ka të drejtë të bëjë oferta speciale për pajtimtarët e tij, oferta të cilat në zbatim të ligjit dhe kuadrin rregullator janë publikuar e njoftuar rregullisht në AKEP. Oferta “Fol Fix 1500” nuk krahasohet me OSHKP, sepse ky i fundit është dizenuar për për thirrje në distancë të gjatë.
- Për sa më sipër, në zbatim të ligjit nr. 9918, ligjit nr. 8485, KPrA, Rregullores së akses interkoneksionit, Albtelecom kërkon: Rrëzimin e pretendimeve të Media+Tel si të

pabazuara me kuadrin rregullator në fuqi, si edhe mbylljen e procedimit administrativ të filluar me VKD nr. 1912, datë 30.4.2012.

- III. Sipërmarrësi Media + Tel sh.p.k. nuk ka sjelle pretendime në zbatim të VKD nr. 1912, datë 30.4.2012, por me shkresën me nr. 572Prot. i AKEP, datë 27.3.2012, “*Kërkesë për fillimin e procedimit administrativ për zgjidhjen e mosmarrëveshjes ndërmjet Media + Tel sh.p.k. sh.p.k dhe Albtelecom sh.a.*”, ka sqaruar si më poshtë:

Media + Tel sh.p.k., deri më datë 26.3.2012, nuk ka arritur të rinovojë marrëveshjen e akses/interkoneksionit me Albtelecom sh.a., për arsye se oferta referencë e interkoneksionit e Albtelecom, është diskriminuese dhe po e çon në falimentim Media+Tel. Gjatë kësaj periudhe, Media+Tel ka kërkuar të negociojë me Albtelecom dhe nuk ka marrë përgjigje pozitive por vetëm presione verbale për firmosjen e kontratës së re me çmime aspak reale.

Prej datës 1.9.2010, Albtelecom ka tarifuar për akses Media+Tel me 3.5 lekë/min pa TVSH, dhe 0.83 lekë/thirrje, ndërkohë për klientët fundorë e shet me çmim më të ulët. Me ofertën “Fol fix 1 500” ofron:

- 1 500 minuta brenda rrjetit të Albtelecom
- 30 minuta me operatorët celularë kombëtarë
- 30 minuta me operatorët fiks në Europë dhe fiks e celularë në Amerikë e Kanada duke përfshirë pajtimin mujor dhe TVSH për 1 500 lekë

Çmimi që Albtelecom po e shet këtë shërbim është më pak se 1 lek/min, pra kostoja është më pak se 1 lek/min, apo Albtelecom po e shet këtë shërbim nën kosto?

Çmimi aktual prej 3.5 lekë pa TVSH për shërbimin e aksesit e ka futur në situatë të vështirë Media + Tel, dhe po e çon drejt falimentimit nëse vazhdohet me këto kushte diskriminuese ndaj kompanive të vogla që operojnë në tregun e ofrimit të shërbimit me kartë të parapaguar. Është detyrim ligjor i AKEP të studiojë tregun e të miratojë ofertën referencë të interkoneksionit të Albtelecom sh.a. Në asnjë vend të BE-së çmimi i origjinimit është 0.03 euro/min për telefoninë fikse.

Me shkresën nr. 4948Prot., datë 1.11.2011, Albtelecom sh.a. i është drejtuar Media + Tel sh.p.k. për plotësim dokumentacioni për nënshkrimin e marrëveshjes së re për akses dhe interkoneksion, bazuar në RIO-n e re. Media + Tel është përgjigjur me shkresën nr. 2Prot., datë 5.12.2011, duke i paraqitur shqetësimin për tarifën e larta të çmimeve të vendosura nga Albtelecom. Tarifat janë shumë të larta dhe se që nga vendosja e tyre Media+Tel ka rënie të të ardhurave më shumë se 50%, duke e futur në pozitë shumë të vështirë financiare kompaninë. Në lidhje me këtë shqetësim Media+Tel sh.p.k., i kërkon Albtelecom zhvillimin e një takimi për të gjetur mënyrën e zgjidhjes së këtij ngërçi që po i sjell humbje të dy kompanive.

Media + Tel sh.p.k bazuar në nenin 120, të ligjit nr. 9918 dhe nenin 46 të K.Pr.A, i kërkon AKEP të fillojë procedimin administrativ për zgjidhjen e mosmarrëveshjes së akses/interkoneksionit për shërbimin e thirrjes me kartë (OSHKP) Albtelecom sh.a.

IV. AKEP, sa më sipër u parashtrua, për çështjet objekt të kësaj mosmarrëveshje pasi shqyrtoi pretendimet e palëve, Media + Tel sh.p.k. dhe Albtelecom sh.a., arsyeton si më poshtë:

- Për sa i përket segmentimit të shërbimit të origjinimit dhe terminimit për OSHKP, AKEP vlerëson se:
 1. Në lidhje me pretendimin e Media+Tel sh.p.k. për tarifën e shërbimit të origjinimit në rrjetin e Albtelecom sh.a., sqaron se, tarifa për shërbimin e origjinimit të thirrjeve prej 3.5 lekë/min, dhe 0.83 lekë/thirrje, është tarifë nën rregullim, e miratuar nga AKEP me VKD nr. 1348, datë 26.7.2010, për *“Përcaktimin e sipërmarrësit Albtelecom sh.a. me fuqi të ndjeshme në treg dhe vendosjen e masave rregulluese në tregjet me pakicë të telefonisë fikse dhe tregjet me shumicë të interkoneksionit të telefonisë fikse”*. Kjo tarifë është aplikuar nga Albtelecom e njëjtë për të gjithë operatorët e OSHKP prej datës 1.9.2010. Pra në kontekstin e diskriminimit midis operatorëve OSHKP Albtelecom nuk ka diskriminuar Media+Tel në raport me operatorët e tjerë. Arsyet pse janë vendosur traifat në nivelin e përcaktuar në VKD nr.1348, datë 26.07.2010, janë dhënë në dokumentin e Analizës së tregut të telefonisë fikse të miratuar me këtë vendim.
 2. Ofrimi nga Albtelecom i paketave tarifore me pagesë fikse më të lartë se pajtimi mujor duke përfshirë minuta falas kombëtare dhe ndërkombëtare në paketë si FolFiks, duket se është përshtatje e Albtelecom ndaj kushteve të tregut dhe konkurrencës për thirrje telefonike edhe nga rrjetet celulare (rritje shumë e madhe e thirrjeve telefonike nga rrjete celulare) dhe jo tentativë për të nxjerrë nga tregu OSHKP. Kjo vihet re edhe në pjesët e tregut të kartave me parapagim të Albtelecom që zotëron vetëm 6% te ketij tregu.
 3. Njëkohësisht sic ka sqaruar edhe më parë në takime me operatorët, AKEP vlerëson se OSHKP kanë pasur dhe kanë mundësitë e ofrimit të shërbimeve të tyre edhe për abonentët e rrjeteve celulare AMC dhe Vodafone, pas vendimeve të AKEP më 31.03.2010, ku ndaj këtyre dy operatorëve celulare janë vendosur detyrime specifike për ofrimin e origjinimit të thirrjeve për OSHKP.
 4. Shërbimet e ofruara nga OSHKP kanë interes direkt publik për pajtimtarët e Albtelecom pasi paraqesin një alternativë për kryerjen e thirrjeve telefonike dhe për kontroll të shpenzimeve telefonike. Këto shërbime rrisin konkurrencën në treg për thirrje telefonike dhe këta operatorë konkurrojnë direkt me Albtelecom: me kartat me parapagim të Albtelecom dhe me thirrjet e kryera normalisht.
 5. Marrëdhëniet e krijuara midis Albtelecom dhe OSHKP-ve në mënyrën e lidhjes së tyre me E1 dhe Pikë Interkoneksioni janë të ngjashme me

interkonektimin e Albtelecom me operatorë të rrjeteve publike në formën e interkoneksionit të bashkvendosur në ambientet e Albtelecom.

6. Nëpërmjet Vendimeve nr. 1599 dhe 1600 datë 22.04.2011, AKEP imponoi dhënien e aksesit për operatorët celularë AMC dhe Vodafone Albania për terminim në nivel njëfish në rrjetin Albtelecom, duke u bazuar në parimet e përfitimit të segmenteve të terminimit nëse operatori përfitues sjell trafikun në pikën përkatëse të interkoneksionit sipas përcaktimeve të RIO;
 7. Për sa më sipër, AKEP me qëllim rritjen e mëtejshme të konkurrencës për thirrje telefonike dhe alternativave të konsumatorëve për të kryer thirrje telefonike gjykon se origjinimi dhe terminimi i thirrjeve edhe për OSHKP duhet të fillojë nga datat 1.07.2012 të tarifohet sipas segmenteve përkatës në varësi të pikës së interkoneksionit ku lidhet OSHKP me Albtelecom, dhe Albtelecom nuk duhet të mohojë aksesin në pika rajonale apo lokale interkoneksioni për OSHKP.
- Për sa i takon tarifës së E1, AKEP ka shqyrtuar këtë ankesë për zgjidhjen e mosmarrveshjes Abissnet-Albtelecom për shërbimin me kartë të parapaguar, dhe me vendimin e marrë për këtë masmarrevshje ka vendosur që AKEP të mos ndërhyjë në aplikimin ose jot ë tarifës apo në nivelin e saj.

P Ë R K Ë T O A R S Y E:

Bazuar në pikën 1 të nenit 114 dhe pikën 1 të nenit 115, të ligjit nr. 9918, nenin 46 e vijues të K.Pr.A, si dhe pikën 17 të nenit 21 të Rregullores së Brendshme,

V E N D O S:

1. Të mbyllë procedimim administrativ të filluar me Vendimin nr. 1912, datë 30.4.2012, për “Fillimin e procedimit administrativ për zgjidhjen e mosmarrëveshjes së interkoneksionit për shërbimet e thirrjes me kartë midis sipërmarrësve *Media+Tel sh.p.k. dhe Albtelecom sh.a.*”.
2. Albtelecom duke filluar nga 1.07.2012 të tarifojë për origjinimin dhe terminimin e thirrjeve për OSHKP sipas segmenteve përkatës në varësi të pikës së

interkoneksionit ku lidhet OSHKP me Albtelecom, dhe Albtelecom nuk duhet të mohojë aksesin në pika rajonale apo lokale interkoneksioni për OSHKP.

3. Niveli i tarifave të origjinimit sipas segmenteve të jetë i njëjtë me nivelin e tarifave të terminimit sipas segmenteve përkatës të përcaktuar në VKD nr.1348, datë 26.07.2010.
4. Media + Tel sh.p.k. dhe Albtelecom sh.a të lidhin marreveshje për shërbimet me kartë të parapaguar duke zbatuar pikat 2 dhe 3 më sipër.
5. Të njoftohen palët e interesuara Media + Tel sh.p.k.dhe Albtelecom sh.a., për mbylljen e procedimit administrativ;
6. Ky Vendim të publikohet në faqen e internetit të AKEP: www.akep.al.

Ky Vendim hyn në fuqi në datën e miratimit të tij.

K R Y E T A R I
Piro XHIXHO

ANËTARË:

- 1. Alban KARAPICI**
- 2. Alketa MUKAVELATI**
- 3. Benon PALOKA**
- 4. Zamira NURÇE**